

EDESA PAHESHTI

**MËNYRA DËSHIRORE NË SHQIPE DHE SHPREHJA E DËSHIRËS
NË GJERMANISHTE**

1. Hyrje - mënyra dëshirore

Nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv.¹ Sipas Gramatikës së Akademisë² dhe Shaban Demirajt³ për gjuhën shqipe pranohen gjashtë mënyra të foljes: *dëftore*, *habitore*, *lidhore*, *kushtore*, *dëshirore* dhe *urdhërore*. Sipas Duden⁴ dhe Helbig / Buscha⁵ në gjermanishte dallohen tri mënyra të foljes: *dëftore*, *lidhore* dhe *urdhërore*. Pra, krahasuar me shqipen, në gjermanishte nuk gjenden: *mënyra dëshirore*, *habitore* dhe ajo *kushtore*.

Termi i mënyrës dëshirore vjen nga latinishtja *modus optativus* – me anë të kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës, dëshirë e folësit në formë urimi apo mallkimi:

Dalsh faqebardhë!

Vafsh në djall!

Mënyra dëshirore në shqipe dallohet qartë si për nga format foljore edhe për nga kuptimet modale përkatëse, pra është një mënyrë e përvijuar. Mënyrën dëshirore nuk e hasim në shumë gjuhë indoevropiane – për të shprehur dëshirën e folësit në këto gjuhë përdoret mënyra lidhore, gjë të cilën e ndeshim edhe në shqipe. Parë në këndvështrimin e asaj që shpreh mënyra dëshirore, intensiteti i përdorimit të saj ka një shtrirje relativisht të kufizuar (ngushtë) si në gjuhën e folur, kryesisht në atë popullore, por jo vetëm, ashtu edhe në atë të shkruar, duke u fokusuar në gjuhën letrare dhe aspak e pranishme në tekste të literaturës me karakter shkencor.

Siç është përmendur edhe më lart, sot në gjermanishte gjuhëtarët nuk e pranojnë apo njohin mënyrën dëshirore si mënyrë më vete. Por ky qëndrim nuk ka qenë gjithmonë kështu, ose të paktën jo kaq i prerë. Historia e gramatikës së gjuhës gjermane na tregon se hasim përdorime të termit *der Optativ* (dëshirore). Ajo çka gjuhëtarët ngrenë si çështje dhe diskutojnë është pikërisht shfaqja e pastër

¹ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 272.

² Po aty.

³ Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike” 1977/3, f. 101.

⁴ DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, DUDENVERLAG, Mannheim – Leipzig – Wien – Zürich, 2005, f.156.

⁵ G. Helbig. & J. Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langescheidt, 2005. f. 168.

ose jo e kësaj mënyre, por nuk e vënë në diskutim që ajo ekziston – midis tri mënyrave tashmë të konfirmuara në gjuhën gjermane, disa autorë kanë pranuar edhe dëshiroren dhe eksklamativin (habitoren), edhe pse me rezerva dhe duke i vendosur në pikëpyetje. *Oppenrider* klasifikon (përcakton) dëftoren, lidhoren dhe urdhëroren në *klasa të mëdha ose qendrore*, ndërkohë që dëshiroren dhe eksklamativin i klasifikon në *klasa të vogla ose periferike* (Rabanus: 2001). Dëshiroren që nuk përmban asnjë përbërës të lidhore, Carnap e quan “*dëshirore të pastër*”.⁶ Disa gjuhëtarë njohin dhe përmendin fjalinë dëshirore (‘*Desiderativsatz*’ në vend të *Optativsatz*) (Duden-Grammatik 2009).⁷ Megjithatë në gjermanishte mënyra dëshirore nuk ka paradigma morfologjike. Diskutimi ngrihet në nivelin se cila mënyrë do të shërbejë për të shprehur dëshirën e folësit, në formë urimi apo mallkimi. Për të shprehur dëshirën e folësit në gjermanishte përdoret mënyra lidhore. Përpos kësaj mënyre gjejmë përdorim edhe një sërë elementesh gramatikore, si: *intonacioni*, apo mjetet leksikore, si: *pjesëzat modale*.

2. Mënyra dëshirore në shqipe

Dëshirorja e shqipes në formatin e saj të posaçëm paraqitet shumë e vështirë për t’u sqaruar historikisht. Në shumë gjuhë indoevropiane ka ndodhur përzierja e lidhore me dëshiroren, ndërkohë në sistemin foljor të shqipes është vërtetuar një prirje e kundërt, ajo për t’i dalluar sa më qartë formalisht kuptimet modale.⁸

I. Kuptimi i përgjithshëm i mënyrës dëshirore

Sipas Gramatikës së Akademisë⁹ dhe Buchholz / Fiedler¹⁰ me anë të kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi apo mallkimi.

Shembuj:

Plaç të preftë, - ...! (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 97)

Geh zum Teufel! (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 14)

Vdeksh!

Ich hoffe, du stirbst!

Mënyra dëshirore ka dy kohë: *të tashme dhe të kryer*. Koha e tashme e mënyrës dëshirore përdoret më dendur se ajo e kryer, e cila për nga vetë funksioni gjen përdorim të kufizuar.

Shembull, koha e kryer:

Të pastë marrë të ligat!

⁶ A. Siegetsleitner, *Ethic und Moral im Wiener Kreis: Zur Geschichte eines engagierten Humanismus*, Böhlau Verlag Ges.. m. b. H. & CO. KG. Wien Köln Weimar, Wien, 2014, f. 155.

⁷ *Kontroversen in der Forschung zu Satztypen und Satzmodus*, <http://www.linguistik.uni-mainz.de/mitarbeiter/meibauer/publikationen/pub-aufsaeetze/Paper>.

⁸ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa II), Tiranë, 1976, f. 22.

⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 329.

¹⁰ O. Buchholz & W. Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 150.

Mënyra dëshirore në shqipe dhe shprehja e dëshirës në gjermanishte

*Er sollte dein Böse **wegnehmen!***

Në rastet kur folësi do të shprehë një dëshirë në kuptim mohor, atëherë foljes në mënyrën dëshirore do t'i paravendoset pjesëza mohuese “mos”.

Shembuj:

*Mos **u plaksh** kurrë!*

*Du sollst nie **alt werden!***

*Mos **pafshi** më ditë të bardhë!*

*Du sollst keine glückliche Tage **haben!***

II. Vështrimi semantiko-pragmatik i mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe

Format morfologjike të kohës së tashme të mënyrës dëshirore përdoren për të shprehur edhe veprime të mundshme në kohën e ardhme, duke u afruar me mënyrën lidhore, pa shprehur dëshirën e folësit në formë urimi apo mallkimi. Përdorime të tilla ndeshen në fjali të varura kushtore dhe lejore, dhe paraprihen nga lidhëza nënrenditëse “në”¹¹

Shembuj:

*Në **u vonofsha**, mos më prit, por bjer e fli gjumë.*

*Falls ich **spät werde**, warte nicht auf mich! Geh ins Bett!*

*Në të **gënjeshta** për këtë gjë, mos më fol më me gojë!*

*Falls ich dich darüber **anlüge**, rede nie ein Wort mit mir!*

*Edhe në e **humbsha** luftën, nga hiri do të ngrihem dhe mbanë do t'ja dal!*

*Auch wenn ich den Krieg **verliere**, aus der Asche werde ich wieder gebären und werde es schaffen!*

Spektri i përdorimit të mënyrës dëshirore nuk është i gjerë. Fjalitë në mënyrën dëshirore shoqërohen shpesh me pasthirrma, si: *ah, aj, uh*. Këto mjete gramatikore i japin ngjyrimë emocionale urimit apo mallkimit të shprehur nga folësi. Fjalitë karakterizohen nga intonacioni ngjithës dhe ndeshen më së shumti në gjuhën e folur, kryesisht në atë popullore, në tekste letrare, përralla apo fabula, dhe nuk gjejnë përdorim në tekste teorike apo shkencore. Përdorimi i dëshirores lidhet kryesisht me ngjarje shenjuese të jetës së njeriut, të ngarkuar me emocione.

Fjalja dëshirore përpos përdorimit të saj në shprehjen e pastër të një urimi apo mallkimi, gjen përdorim edhe në struktura fjalish kushtore apo lejore.¹²

Shembull:

*Në të **zënça**, di unë ç'të bëj!*

*Ich werde es dir zeigen, falls ich dich **fange!***

3. Shprehja e dëshirës në gjermanishte

Në gjermanishte si fjali dëshirore përcaktohet një lloj fjalie e cila shërben për të shprehur një dëshirë. Në gjermanishte nuk gjendet një mënyrë dëshirore e

¹¹ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 329.

¹² O. Buchholz & W. Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 150.

mirëfilltë, e pavarur, por për të realizuar fjali dëshirore përdoren format e mënyrës lidhore (**Hätte ich doch nichts gesagt!** – Ah, sikur të mos kisha thënë gjë!)¹³

Nga ana formale fjalia dëshirore s'është gjë tjetër veçse një fjali kushtore e paraprirë nga lidhëza “wenn” (nëse) e shoqëruar me intonacion special, si dhe me pjesëza të ndryshme modale (Abtönungspartikeln): *Wärst du doch gekommen! Wenn du doch gekommen wärst! (Të kishe ardhur! Ah, sikur të kishe ardhur!).*

Duke qenë se në gjermanishte nuk gjendet një mënyre dëshirore të mirëfilltë, në gjermanishte për të shprehur urimin apo mallkimin e folësit përdoren një kompleks elementesh morfologjike, sintaksore dhe semantike: *mënyra dëftore, ajo lidhore, folja modale “sollen” (duhet) si dhe pjesëzat modale ose siç quhen në gjermanishte Abtönungspartikeln¹⁴: bloß, doch, nur (posi), si dhe intonacioni.*

Shembuj: mënyra dëftore,

Es lebe die Freiheit!

Rroftë liria!

Në rastet kur dëshira që shpreh folësi mund të jetë e realizueshme, përdoret mënyra lidhore në kohën e tashme.

Shembull:

Hoffentlich gewinnst du!

Shpresojmë të fitosh!

Në rastet kur dëshira e shprehur nga folësi nuk është e realizueshme, përdoret mënyra lidhore në kohën e pakryer ose më se të kryer.

Wenn doch unser Team gewonnen hätte!

Sikur të kishte fituar skuadra jonë!

Wenn du doch alle hättest helfen können!

Sikur të kishe mundur t'i ndihmoje të tërë!

Shembuj: folja modale „sollen” (duhet):

Der Teufel soll dich holen!

Të marrtë djalli!

4. Ndërtime me folje në mënyrën dëshirore në shqipe dhe shprehjet përgjegjëse në gjermanishte

Koha	Shqipe	Gjermanishte
E tashme	Rroftë liria!	Es lebe die Freiheit! (Mënyra lidhore, koha e tashme + intonacion special + pikëçuditëse)

¹³ E. Hentschel, *Deutsche Grammatik*, Der Gruyter, Berlin, 2010, f. 215.

¹⁴ Termi *Abtönungspartikeln* ose pjesëzat modale është përdorur për herë të parë nga Weydt (Hentschel und Weydt, 1990, f. 280). Pjesëzat modale nuk sjellin asnjë informacion të ri në fjali. Ky koncept nënkupton që përmes këtyre pjesëzave do të ngjyrosot diçka, pra një mendimi do t'i jepet ngjyrim modal (Karin Schwiegerr, 2006/07, f. 4). Ato gjejnë përdorim të shpeshtë në gjuhën e folur. Shumica e studiuesve dhe gramatikanëve i pranojnë pjesëzat modale si njësi të pastra të mesfushës të fjalisë, me pozicione relativisht të lira. Në më të shumtën e rasteve ato janë të patheksuara. (Ulrike Hammer, 2005, f. 3-4)

Mënyra dëshirore në shqipe dhe shprehja e dëshirës në gjermanishte

	T'u thaftë goja! (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 80) Pika të rëntë – tha nëna ... (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 112)	Die Zunge soll dir verdorren! (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 85) (Folja modale “sollen” (duhet) në kohën e tashme + intonacion special + pikëçuditëse) “Hol dich der Kuckuck!” sagte Mutter. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 121) (Mënyra urdhërore, koha e tashme + intonacion special + pikëçuditëse)
E kryer	Të pastë marrë të ligat!	Er sollte dein Böse wegnehmen! (Folja modale ‘sollen’ në kohën e shkuar + intonacion special + pikëçuditëse)

Kur i kthejmë fjalitë e mënyrës dëshirore të shqipes në gjermanishte nuk realizohet ekuivalencë e plotë. Edhe pse ekziston kuptimi dëshiror i foljes dhe i fjalisë dëshirore, përsëri ekuivalenca midis këtyre strukturave nuk është e plotë. Midis tyre ka dallime, shpesh të qenësishme. Dallimet mund të jenë të rendit semantik ose ngjyrim semantik, të rendit stilistik dhe të rendit emocional.

Aspekti stilistik, pragmatik nisur nga fakti që dëshirorja e shqipes përdoret me formula të gatshme dhe me përdorim të gjerë në jetën e shqiptarëve. Ndërsa kur përkthehen këto fjali në gjermanishte, nuk gjejmë formula të gatshme, si në shqipe:

Të bëftë mirë!

Möge es dir gut tun!

Përkthimi në gjermanishte është i papërdorshëm, na jep një ide të zbehtë, por nuk paraqet apo ofron asnjë atmosferë përdorimi. Po kështu edhe shembujt e poshtëshënuar:

U bëfsh 100 vjeç!

Du sollst 100 Jahre alt werden! (Herzlichen Glückwunsch!)

Të trashëgojeni!

Ihr sollt Nachwuchs haben! (Wir wünschen euch beiden viele Kinder!)

Ngjyrim i rendit emocional:

Shembuj:

Në shkoftë njeri, tregona!

Falls jemand vorbei geht, sag uns Becheid!

U verbofshi! (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 69)

Ihr Augenlicht soll versiegen! (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 73)

Në shembujt e shqipes kemi ngjyrim emocional, ndërsa në përkthimin në gjermanishte nuk e gjejmë këtë ngjyrim – paraqitja emocionale që transmetohet në gjermanishte është neutrale.

Dallimet midis fjalive në mënyrën dëshirore në shqipe dhe prodhimeve të tyre në fjali dëshirore në gjermanishte janë të gjitha niveleve: kur këto urime përkthehen në gjermanishte nuk e bartin vlerën e urimit. Përsa i përket ekuivalencës morfologjike ajo është zero. Ndërsa për ekuivalencën kuptimore mund të thuhet që është e vakët.

5. Përfundime

Gjuhëtarë shqiptarë apo të huaj kanë mbajtur qëndrime të ndryshme përsa i përket njohjes së mënyrës habitore në shqipe – një palë e kanë trajtuar si mënyrë më vete, një palë tjetër e kanë parë si pjesë të mënyrës dëftore.

Në shqipe me anë të mënyrës dëshirore folësi shpreh një dëshirë në formë urimi apo mallkimi: **Dalsh faqebardhë!**

Në gjermanishte nuk gjendet mënyra dëshirore, edhe pse haset fjalia dëshirore, e cila shërben për të shprehur një dëshirë. Për të realizuar fjali dëshirore përdoren format e mënyrës lidhore: **Wäre ich doch gekommen!** – Ah, sikur të kisha ardhur!

Në gjermanishte për të shprehur urimin apo mallkimin e folësit përdoren një kompleks elementesh morfologjike, sintaksore dhe semantike: *mënyra dëftore, ajo lidhore, folja modale "sollen" (duhet) si dhe pjesëzat modale ose siç quhen në gjermanishte Abtönungspartikeln: doch (posi), si dhe intonacioni.*

Intonacioni si mjet gramatikor luan një rol të rëndësishëm në shprehjen e dëshirës në gjermanishte edhe në shqipe duke luajtur një rol të rëndësishëm në dhënien e fuqisë së asaj që duam të shprehim. Në të dyja rastet fjalitë karakterizohen nga intonacioni ngjithës.

Kuptimi kohor është i njëjtë në të dyja gjuhët: i tanishëm, i shkuar dhe i ardhshëm.

Shembuj:

Rroftë liria!

Es lebe die Freiheit!

Të pastë marrë të ligat!

Er sollte dein Böse wegnehmen!

Spektri i përdorimit të mënyrës dëshirore nuk është i gjerë. Format e dëshirores si në shqipe edhe në gjermanishte më së shumti hasen në gjuhën e folur ose në vepra letrare të bazuara në gjuhën e folur (përralla), dhe nuk gjejmë përdorim në tekste teorike apo shkencore. Përdorimi i dëshirores lidhet kryesisht me ngjarje shenjuese të jetës së njeriut, të ngarkuar me emocione.

Fjalitë në mënyrën dëshirore në shqipe shoqërohen shpesh me pasthirrma, si: *ah, aj, uh*. Praninë e këtyre pasthirmave e gjejmë edhe në ndërtimet gjegjëse në gjermanishte.

Kur i kthejmë fjalitë e mënyrës dëshirore të shqipes në gjermanishte nuk realizohet ekuivalencë e plotë. Midis tyre ka dallime, shpesh të qenësishme.

Mënyra dëshirore në shqipe dhe shprehja e dëshirës në gjermanishte

Dallimet mund të jenë të rendit semantik ose ngjyrim semantik, të rendit stilistik dhe të rendit emocional.

Përkthimi në gjermanishte është i papërdorshëm, na jep një ide të zbehtë, por nuk paraqet apo ofron asnjë atmosferë përdorimi.

Në përdorimet e mënyrës dëshirore në shqipe hasim ngjyrim të fortë emocional, ndërsa në përkthimin në gjermanishte nuk e gjejmë këtë ngjyrim – paraqitja emocionale që transmetohet në gjermanishte është neutrale.

Dallimet midis fjalive në mënyrën dëshirore në shqipe dhe prodhimeve të tyre në fjali dëshirore në gjermanishte janë të të gjitha niveleve: kur këto urime përkthehen në gjermanishte nuk e bartin vlerën e urimit. Përsa i përket ekuivalencës morfologjike ajo është zero. Ndërsa për ekuivalencën kuptimore mund të thuhet që është e vakët.

BIBLIOGRAFI

- A. Siegetsleitner, *Ethic und Moral im Wiener Kreis: Zur Geschichte eines engagierten Humanismus*, Böhlau Verlag Ges. m. b. H. & CO. KG. Wien Köln Weimar, Wien, 2014.
- DUDEN – *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Seite 156, DUDENVERLAG, Mannheim – Leipzig – Wien – Zürich, 2005.
- E. Hentschel, *Deutsche Grammatik*, Der Gruyter, Berlin, 2010.
- Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- G. Helbig & J. Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2005.
- Kontroversen in der Forschung zu Satztypen und Satzmodus*, <http://www.linguistik.uni-mainz.de/mitarbeiter/meibauer/publikationen/pub-aufsaeetze/Paper>
- O. Buchholz & W. Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987.
- Sh. Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970.
- Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa II), Tiranë, 1976.
- Sh. Demiraj, *Studime filologjike “Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe”*, Tiranë, 1977.

